

Gjethnajë shpirti



Gjethnajës së shpirtit

**Gjethnajës së shpirtit
fëshfërijnë mendimet**

**Gjete më gjete
peshojnë dhimbjet,
e me pika vese
ujis sythe shprese**

**Gjethnajës së shpirtit
fëshfërijnë mendimet,
në përcjellje të vjeshtës
mbi gjete mundimet**

Poezi



Titulli: Gjethnajë shpirti

Autori: Vera Istrefaj

Kompjuterizoi: Veronik Istrefaj

Kopertina: Klevis Istrefaj

Shtëpia botuese:

ISBN: Prishtinë 2019



Kush është Vera Istrefaj?

Vera Istrefaj është lindur në Kukës më 1 nëntor 1975. Që në vegjëli ka botuar vjersha dhe skica në shtypin e kohës. Në vitin 1991 është paraqitur në një Almanak të krijuesve me 76 poezi dhe me një skicë. Që prej asaj kohe ka botuar herë pas here brenda dhe jashtë Shqipërisë në shumë media të shkruara. Ka qenë pjesëmarrëse në shumë konkurse letrare ku edhe është nderuar me çmime.



Ka botuar librat :

"Shiu i fundit"

"Nënqeshja e ëmbël"

"Në akuj digjem"

"U jepem udhëve"

"Qielli i shpirtit tim"

"Vesë shpirti"

"Lirikat e Pikëllimës"



Është juriste me titull shkencor “Master i Shkencave Juridike Penale“. Znj. Istrefaj është aktiviste e shoqërisë civile për të drejtat e njeriut me një eksperience 20 vjeçare si drejtuese e Qendrës së Këshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale. Gjithashtu, është koordinatore e rrjetit “Barazi në vendimmarje” për Qarkun Kukës. Në vitin 2009 është nderuar me “Mirënjohje për kontributin e dhënë në komunitet” dhe është përzgjedhur një ndër 10 personat më aktivë në rang kombëtar. Në vitin 2018 është nderuar me “Çmimi jubilar i Skenderbeut për paqen“ nga Komiteti i Pajtimit Mbarëkombetar Shqiptar. Është e martuar dhe është nënë e dy djemve. Punon e jeton në Kukës, ku është kryetare e “Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë” – Dega Kukës



Ditë të brishta

Çdo mbrëmje
i vesh ditët e mia me pritje

Në mëngjes
i vesh me buzëqeshje
se janë ditët e mia
qofshin edhe të trishta.

Janë të brishta



Flatra shpresës

Plagë e zemrës time
bulon mirësi

Në ritmikë zemre
dridhet dhimbja

Petalet e shpirtit
lulojnë monotonisë

M'i japin flatra shpreses
humbur njerëzisë



Drithërimë

Dëgjoje vështrimin tim,
mos u huto buzëve
për fjalën në pritje

Qerpikëve
po më driton
një rreze drite

Nuk ka errësirë
në mendjen time

Peng më mbeti zemra
e një drithërimë



Frikë

E theve
pasqyrën e shpirtit tim
se nuk e shihje dot veten



Sirtaret e zemrës

Nga e djeshmja
dua të marr
vetëm mendimet e bukura
që s'po i gjej
ku janë të strukura

Sirtaret e zemrës
i kam mbyllur

Tejmbushur janë me dhimbje

Mbeta në kërkim
të qetësisë së shpirtit tim



Shtrat trishtimi

Sonte
hëna ma marrosi gjumin

Qetësinë
ma rrëmbeu mendimi

Më ka mbetur
vetëm shpirti
në shtrat trishtimi

Po më vardiset
një gotë verë
por s'e dua etjen

Zemra
kërkon prehjen



Qerpikëve
po më vallëzon lodhja

Gjumi marrosur
gulçimeve pa sosur

Qetësia
më qesëndis,
shpirtin ma gris

Sa më parë
ardhtë agimi
ta braktis
këtë shtrat trishtimi



Lëndinë shpirti

Ky behar
borën po shkrin
lëndinë së shpirtit tim



Velat e shpirtit

Mendimet e mia
kanë flatra
e m'ï zптоjnë
velat e shpirtit.



Dhimbje grykëzënë

Grykëzënë
ti, dhimbja ime.

S'i jep shteg
një ulërime



Britmë trishtimi

Nga keqardhja për ty
do të të jap një mundësi
-mungesën time.

Ndjesitë e tua
do të shterpohen
e fjalët
s'do të të kenë
peshë mendimi

E qeshura jote
do të jetë
britmë trishtimi.



Hapsirë

Shpirti im
nuk ka vend
në portofolin tënd

Shpirti im
ka flatra,
s'e duron kafazin.

E merr me vete
hapsirave
marazin.



Çelës i mendjen time

Nuk mund ta vësh në xhep
çelësin e mendjes time

Mendimet e mia
nuk janë ujë
i përroit tënd në tharje.

Mendimet e mia
janë vesë mbi lule,
mjergull mbi liqe,
avuj mbi re

Humb shpesh nëpër to,
por hapsirave

Ndaj
nuk kam çelës të mendjes
për xhepin tënd.



Lumë i qetë

I vargëzova
dhimbjet e mia,
i tejshkova
në ritme zemre.

I vara në mur
relike të shpirtit

Çdo natë
i shoh,
zhytem në to

Eshtë bërë lumë
trishtimi im,
lumë i qetë.

Kjo më vret!



Në dridhje qerpiku

Rrahje budallaqe
të kësaj zemrës time,
udhëtoni shtruar
ndenjës plot mundime

Në dridhje qerpiku
loti është fshehur
ka frikë që të rrjedhë
në këtë çast të dehur

Vënë e ka përpara
ndjesi e mendim,
dihatje e shpejtuar
s'e mbyt dot këtë trishtim



Dhimbja kalëron
në stuhi të shpirtit,
Don Kishot i mbetur
drejt infinitit

Ju rrahje të zemrës
zini çastin rob,
këtë herë trishtimin
nuk e mbysni dot.

Vijoni fluturimin
mbi lum të trishtimit,
ju rrahje naive
të çastit të gëzimit

Le të jetë ky çast
vesë mëngjesore,
Lëreni kujtimin
le ta zërë për dore!



Lodhje buzëqeshjesh

Lodhur qenkan sonte
buzëqeshjet

Urimet
krejt të thata

Në këtë natë mesdimri
trokëllima e gotës
pa jetë

Gati në sosje
edhe fjalët
e dritë e syve
drejt tretjes



Prapë
trokëllima e gotave...

Sa etje...

Qenka sosur
edhe uji mbi tavolinë

Heshtja
po shuan urinë



Terri i brengës

Krahëlakuriqe
frika ime

Endet
territ të brengës
dridhja e zemrës,
në krahë të brishtë
si të trishtilit

Gëzimi po venitet
dritës së kandilit.



Rrezja e agimit

Kjo natë
ma mori gjumin,
ma tendosi
fillin e mendimit

Në qepalla,
zgjuar rreze e agimit.



Peshë dëbore mbi petal

Po afrohet pranvera

Hapat i ka të lehtë
e pesha e borës mbi petal
e rëndë

Por...nuk është sosur durimi.

Po bie nga manushaqja dimri



Në prehër të Pashtrikut

Në prehërin tënd Pashtrik
sot ula kureshtjen time

Dihatja jote
ma trazoi mendjen

Qetesi...

Takimi me retë
nuk ishte i shkretë

Ja...
...një këmborë...
...një qengj në borë



Kënga e jetës,
shtegëtim i bletës
luleve të bardhësisë
notat e qetësisë

Më mbeti nje copëz shpriti
në prehrin tënd

Flladi i pranverës
do ta përkunde
ne djepin e halleve,
e mendimi në përplasje
honeve, maleve

Në prehrin tënd Pashtrik
sot ula kureshtjen
Por...
U rrit dhimbja!



Në kthetra të ëndërrës

Në kthetra të ëndërrës
përpëlitet gjumi,
më flë veç qepalla
rraskapitet truri

Peshon lehtë dëshira
pupël kanarine,
nuk gjen vend mëshira
në udhë të zemrës time



Lule mbi varr zemre

Ndjesitë e mia
i bëj buqetë
për t'ï vënë
mbi varrin e zemrës

Dihatja,
ritmikë e dhembjes

Shpirti vërtitet
si zog pa drejtim
e qielli rënduar
me re e pikëllim



Përkundje gjumi

Krahët e tu të fortë
përqafuan
fatin tim të brishtë,
e jeta na fali
mot të trishtë

Je lodhur, e di
por, kur unë të buzëqesh
ti me qesh me sy.

I gjatë udhëtimi yne
halleve,
pesha e jetës,
peshë e maleve

Shpesh
krenarinë perkulim

Ti hesht
e në frymëmarrjen tënde
ma përkund gjumin.



Valle zemërimi

Ç'është kjo valle e panjohur
e tërhequr nga zemërimi
Dale, dale në të folur
të ka vënë para tërbimi

Jepi hop një frymëmarrje
edhe fjalës pak mendim,
në do ti që në të ardhmen
të mos biesh në turpërim



Hapërim stinësh

Ky dimër
po rend drejt pranverës,
i dha jetë
gjembit të ferrës

Po hapërojnë stinë
të pushtojnë njëra-tjetrën

S'e njohin më vetveten



Ora e jetës

Sytë
ta tregojnë shpirtin e vdekur

Qesh sa të duash,
jepi vetes

Unë e shoh,
të është ndalur
ora e jetës

Ti
vetëm sa frymon

Zemra jote
rrahje mekanike

Keqardhje për ty
femër “fotozhenike”



Varg perlat e shpirtit

Në fjalën tënde
i kam shkuar
perlat e shpirtit,
i kam varur
gjerdan në gushë.

E dhimbja,
po më përpëlitet
mbi prush



Pragut të shpresës

Nuk e di se si,
përherë,
eci mbi të njëjtën udhë
drejt pragut të shpresës

Fort trokas në derë,
se nuk e gjej dot
çelësin e zemrës



Në krahë trishtili

Në krahë trishtili
shtegëton ëndërra ime

Me flatrat e shpirtit
në garë janë vënë

Në qiell shpresën time
një re e ka zënë

Hov i fluturimit
m'i jep krahë shpresës,
ëndërra shuan etjen
me bulëzat e vesës.

Krahët e trishtilit
mbetur fluturim
e flatrat e shpirtit
rrahin pa mbarim



Tutje lakmitar

Nëse nuk e ndien
lehtësinë e prekjes,
ç'të duhet dora ime?

Po prushi i buzëve,
nëse në shpirt nuk të djeg?!

Mungesa ime,
nëse trupin nuk ta drithëron,
përse më kërkon?

Tutje lakmitar
që s'di të peshosh
ekzistencën time!



Jam e brishtë,
e trishtë,
por e vërtetë,
plot jetë

Në vazon e jetës
shuaj etjen
me pikën e vesës

Në dritaren tënde
kanarinë s'mund të jem

As stoli
në dhomën tënde
ftohtësi.



Ngjyrë e dhimbjes

M'i jep ngjyrë dhimbjes,
le të pikojë
edhe ngjyrë gjaku

Dhimbja pa ngjyrë
çfarë është?!

M'i jep kuptim, së paku

Se dhimbja
duhet të çelë,
qoftë edhe gjemba

Eshtë formë e jetës,
formë e shpresës



Gjembat e dhimbjes time
le të jenë
lule të një stine

Edhe në ardhhtë një stuhi
do të sjellë ca pika shi

E kur shiu
të puthet me rrezen e dritës
gjembat do të bëhen rrëzëllitës

Ngjyra e dhimbjes
në petal të lules do të dalë
qoftë edhe për pak
e se dhimbja
do të jetë e vdekur
s'do të kem merak



Me gjuhën e heshtjes

Jeta
po m'i flet vjeshtës
me gjuhën e heshtjes
Dimrit
ia ka veshur
grinë e trishtimit

Kur vjen pranvera?!
Shtegëtimi i shpirtit
s'ka të sosur

Pasqyrë e jetës
ciflosur
Asgje nuk më ka mbetur
veç rreze-shpresa ndezur

Vitet varg e varg
po më lënë në prag



Portat e shpirtit

Kur i mbyll sytë
më hapen portat e shpirtit

Vallëzueshëm
vërshojnë ndjesitë,
kalojnë caqet e mitit

Mendimet...
Ah, të shkretat mendime!
Enden aty-këtu
në ndërgegjen time

Cdo qelizë
ma mbështjell ëndja
e indet lulojnë
plot jetë



Gulçimin s'e ndal
zemra djegur në mall

Qepallat
nuk guxoj t'i hap

Zgjimit
i iki me vrap

Flatra mori
ndjesia ime,
flatra ëndërre
e trupi
peshë pende



Fle me muzën

Mëngjesi i hershëm
me freski
ma përkëdhel buzën,
unë fle me muzën

S'e dua zgjimin
se ma prish ëndërrimin

Zgjimi
ma përcjell ëndërrën,
ëndërrën femërore
aromë lulebore



Po , po!
çdo zgjim
ma lë shpirtin jetim

Symbyllja...

Kjo ma mëkon shpresën

Aty
takohen në fshehtësi
malli im
e prushi yt

Tek veson
përpëlitem

Largimi ynë
lak në fyt



Ylli i mëngjesit
m'i çel sytë
e perlat e shpirtit
m'i zhyt

Gur në zemër
ky yll

Endërrën ma vesh
me dritë mëngjesore
si koracë e breshkës
e unë, gjithë ditën e lume
endem shpresës

Po, po
s'ka rëndësi
dhe pse sytë i mbyll

Në atë errësirë
ty të kam yll



Qelizat
m'i mëkon me jetë
e ëndërra
më merr fletë

E di,
mëngjesi prapë do të vijë
e puthjet e tua
do t'i ketë stoli

Edhe dihatjet e zemrës
përkundëse të ndjenjës
Buzën e puthur
krahëflutur

Përkëdheljet
do të trazojnë
aromë dashurie

Në pritje të symbylljes
kjo ëndërr vajzërie



Netë të pagjuma

Shumë netë të pagjuma

A thua jam
totalisht e humbur?!

Më shumë rudha,
më shumë dhimbje,
më shumë lodhje?

Apo...

Ngushëlloj veten
se jam me hallet
më shumë se me ditët e jetës



Po aq me mendimet

A thua
më shumë jetoj!?

Apo jeta
m'i vë më larg vdekjes?!

Apo e kundërta?!



Pesha e rrahjezemrës

E di ti ç'kam në zemër?!

Pse nxiton t'i vësh emër?

E ndien rrahjen time,
peshën e saj?

Mendo ç'të duash
ti pastaj



Hënë prapa reje

Ti hënë që për një hop
fshihesh pas një reje,
ma shkruanbon këtë zemër
si shkrepëtimë rrufeje



Takim me brymën

Një shall i afshtë
ma zë frymën

E në mëngjesin e hershëm
ndjesia ime takon brymën



Rrufitje hallesh

Me këtë filxhan kafeje
ku rrufis ithtësinë e halleve
dhe forcën e jetës
për t'i dhënë jetë shpresës,
puthem çdo ditë

Në takim të buzës
me kafeinën,
e nis rutinën

Me tringëllimën e monedhës
mbi tavolinë
i bëj thirrje vetes
të braktisë mërzinë



Fund i qetë

Rrjedh ti përrua
bashkë me hallet.

Më merr dhe mua

Rrjedhës sate
le të tronditet shpirti
që qetësi
kurrë nuk diti

Nëpër shkumë
le të përpëlitem unë

Fundi yt
fund i qetë

Edhe i imi, le të jetë!



Gjethnajës së shpirtit

Gjethnajës së shpirtit
fëshfërisin mendimet

Gjethe më gjethe
peshojnë dhimbjet,
e me pika vese
ujis sythe shprese

Puhizë e pranverës
freskon shpirtidjegien



Kohë mbi kohë,
dhimbje mbi dhimbje
mbjell fidanë të jetës

Me rrezet e diellit
përkëdhel ëndërrat

Pranverohet shpresa ime
çdo vit që ik!

Gjethnajës së shpirtit
fëshfërisin mendimet,
në pritje të vjeshtës
mbi gjethe mundimet



Në kujtime duke shkelur

Do ta marrim shpesh këtë udhë
nëpër kujtime duke shkelur,
jetësosur do mbërrijmë
dëshirë patretur

Hap mendimi duke hedhur
e ndjesitë gjeth më gjeth,
fëshfërima e mendimi
bëhen bashkë , shpirti na ther

Pikëlon dhe dhimbja-vesë
hap i çalë, pa siguri,
vetëm koha s'di të presë
gjithë të tjerat janë aty



Pëshpëritje

Ky mëngjes
me ëmbëlsi
më pëshpëriti në vesh

Me rreze dielli
më puthi

Ndryshe,
krejt ndryshe
ky mëngjes i ri

Planet e ditës
më varen supeve
e mendja
më vrapon tek ti

E paskam harruar veten
në ëndërr,
fjetur në ty



Puthje me valën

Degët e shelgut
puthen me valën e ujit
e pikojnë lot të dehur
Dhimbja ime e bukur
s'ka të prehur
Gurët e përroit
janë fjalët që s'ti thashë,
e puhiza e erës
jemi ne, bashkë
Ka kohë
që asnjë pranverë nuk po mund
gonxhet e shpirtit të mi çelë
Vijon
me valën të puthet shelgu,
e nëpër lumë
rrjedh pengu
Përplaset brigjeve
pengu i dhimbjes,
brigjeve të shpirtit



Harrim

Mall e shi
me gjethet e vjeshtës
kacafyten,
ankthi e dhimbja
rriten

çdo hap i hedhur
si udhë pa kthim,
mysafiri i pritur
mbeti harrim

Mall e shi,
shpirti stuhi



Në lotin e trishtimit

Fjala e pathënë
mbeti hënë,
por hënë prapa reje
e fshehur prej meje

Dhimbja m'u bë qiell
e shpresa
mbeti zog në fluturim

Fjala e pathënë
pikon trishtim

Netët e heshtjes
zhytur në terr,
gjumin e harresën
çdo natë m'i merr

Nuk po tretet dhimbja
në lotin e trishtimit



Mantel gjethesh

E kam veshur me vjeshtë
dhimbjen time

Mantel gjethesh
për dritherima

Kupën e shpirtit
plot aromë frutore

E kam thirrur erën
të m'i shpërndajë mendimet,
e shiun
të m'i zbusë plagët e shpirtit.

Më përpëlitet frika
në pritje të dimrit



Si zogj të hutuar

Në mështeknat e qytetit
përplasen mendimet tona
si zogj të hutuar

Përshendesim njeri-tjetrin
me buzëqeshje të varura
si gjethet e pemëve
këtë fundvjeshtë

Trungjebardhat
dëshmojnë ankthin
që fort na ka zënë për fyti

Edhe kjo vjeshtë
gati iku!



Puhizë nëpër petale

Puhizë nëpër petale
lodron ndjesia ime

Në flatra blete
përkund gjumin,
por nuk fle dot

Nuk i mjafton as qielli
për qetësi

Endet aty-këtu,
lehtaz
ndjesi-puhiza



E unë shpirtin
petaleve e nisa

Peshën e aromës
më ka ëndërra,
e dritën e diellit
ma bart shpresa

Puhizë nëpër petale
ndjesia lodron,
nektarin e jetës mëkon



Trokitje e dielltë

Ky nëntor
trokiti i dielltë sivjet

I grimon ditët e ftohta
me prarim

Vjeshtë lajkatare
në qytetin tim

Me shije ftoi
mashtrohen ndjesitë
tek duart fërkohen



Mpirja
s'mbeti veç në gishta,
por edhe në shpirtra

Ky nëntor prarues
nuk i zbeh dot dhimbjet
që kacafyten me avujt

Të akullta kanë mbetur mendimet



Frymim fjalësh

Një shall i afshtë ankthi
mbërthyer më ka
frymimin e fjalëve

Mendimet strukur në tru
nga dhimbja janë drunjëzuar

Fjalët grykëzëna
s'puqen me mendimim,
mes tyre kanë trishtimin

Shalli i afshtë prej ankthi
s'e përballon dot dimrin



Nuk qasen ëndërrat

Ka kohë që në jastekun tim
nuk qasen ëndërrat

Qëllimet
tutje ma hedhin gjumin

Në udhëtimin e të pesëdhjetave
nuk po ngopem me kohë

C'është kjo rendje?!

Përpjekjet
janë në lëvizje
si dikur unë në lodrime



Sfilitëse rendja ime,
por e bukur!

Drejt qëllimeve
jam bërë flutur

E di stacionin tim,
por dua të mbetem në udhëtim



Pa rigë fjalësh

Pikë vese
mbi gjethe vjeshte
shpresa ime

Mjafton një erë
ta hedhë mbi re
ose përdhe

Vjeshtëruar
janë bisedat në rrugë,
pa rigë fjalësh

Bëhen bashkë me rrëmbim
një grup valësh mbi Drin
e pikëz vese
mbi gjethe vjeshte
mbeti shpirti im



Ah dhimbjet e mia...

Fatlume janë gjethet e pemëve
së fundmi, ato humus kthehen,
por dhimbjet e mia...

Ah dhimbjet e mia...

Nuk do të mund të treten



Litarët e shiut

Këta litarë shiu
në zbritje nga qielli
m'i kanë lidhur shpresat
që presin rreze dielli

Me peshën e dhimbjes
ngjitur gjer në re
kam mbetur rënduar
sot më shumë se dje

Litarët e shiut
e fjetet e shpirtit
keq janë ngatërruar
në këtë stinë të vitit



Puthje mbi gjethe

Kjo erë vjeshte
ma mori puthjen mbi gjethe

Puthja ime
shëtiti frikësuar nën re

Tashmë
shpresë për të nuk jemi ne

Gjethe vjeshtake
bart puthjen me vesë
dhe era e nëntorit
nuk ka besë



Në çast bëhet stuhi
e puthja mbi gjethe
nuk ka siguri

Gjethe verdhacake
zër vend në një fole,
kur të kthehen zogjtë
të puthen për ne



I ftohtë çdo agim!

Mjegulla
zgjohet çdo ditë me qytetin tim

Në ikje
puthet me malet

Në qepallat tona,
rëndim.

Kjo mjegull
mbështjell shpresat tona

I ftohtë çdo agim!



Nën pushtet të mjegullës

Gjalica ngre kryet si ajsberg
i rri Pikëllimës përbri,
mjegulla vë gjithcka nën pushtet
qyteti ka veç një ngjyrë, gri

Pashtriku dy zonjat përshtëndet
tek ngrihen kryelarta gjer në re,
Drini vijon udhëtimin e vet
nën pushtet të mjegullës qyteti edhe ne



Rradhitmi dhimbjet!

Hej, ti peshkatar
që përkëdhel dy Drinat
ndalu pak!

Merri dhimbjet e mia,
rradhiti në varkë

Hidhi diku,
por jo në turbullirë

Dhimbjet e mia
të mbërrijnë të kristalta
gjer në det

Aty,
pafundësia i pret



Më duhesh si diell

Në krahë pëllumbi
u shkrua dhimbja ime,
e malli për ty
u përplas në qiell

Më duhesh si diell

Nuk i mungon shtratit,
por shpirtit
Nuk i mungon prekjes,
por syrit

Retë gri
më ndajnë nga ti



Kujtimi pushtues

Unë e di,
ti ia del pa praninë time.
por kurrë pa kujtimin tim

Kujtimi im
është freskia e puhizës në pranverë,
fladi veror

Kujtimi im
ka bardhësinë e dimrit
dhe fuqinë e shpirtit

Kam mbetur kujtim,
pushtues pa mbarim



Xhepfryrë

Në fëshfëritje fustani
përpëlitesh,
mbetur nën taka femrash
dot nuk ngrihesh

Sa i vogël ke mbetur!

Kilogramët dhe vitet
nuk ta shtojnë madhësinë,
as xhepat e fryrë

Ke mbetur i vogël dhe i ndyrë!



Shtrije shikimin!

Shtrije shikimin,
mos ki frikë

Mirësisë
asgjë nuk i ikë

Lëri sytë të lirë
të shijojnë,
aq kohë sa ligësitë
s'të zптоjnë

Eshtë njerëzore, o njeri,
të vlerësosh bukuri



Dikujt...

T'i njoha hapat...
Të rëndë, të vrazhdtë...
si ti vetë

Koha...Ah koha,
Eshtë pasqyra e gjithkujt,
e gjithçkaje

Shihu mirë në këtë pasqyrë
sa je në kohë

Do të me vinte keq
të ikje nga kjo botë
pa njohur veten



Zjarrin mbajmë ndezur

Lehtas më pulitesh
gjithë ditën ndër sy,
gjersa vjen dhe mbrëmja
e të gjen aty

Shtrihesh e zë vend
aty mbi qerpik,
e gjumit të natës
ti m'i thua -ik!

M'i vë flatra shpirtit
ëndërrave syhapur,
notojmë në njëri-tjetrin
si në det të kaltër

Bashkë ndër dekada
zjarrim mbajtëm ndezur,
prush i këtij zjarri
lodhjen ma ka tretur



Ja diku mbi ballë
më lodron një thinjë,
dridhem afër teje,
fletë trëndeline

Rrudha në cep syri
fshihet para teje,
por vështrimi yt
nuk shqitet prej meje

Djemtë na “përqeshin”
kur bëj ndonjë naze,
përskuqja e ndrojtur
na pushton në faqe



Valë e Drinit shkumëzore

Më ke shtyrë gjethe në Dri
erë e marrë, gati stuhi,
por stuhia heshtazi
brenda shpirtit po më rri

Valë e Drinit shkumëzore
ikën tutje me tërbim,
e ka zënë, s'e lëshon dore
këtë copëz të shpirtit tim

Ere e marrë nëpër qytet
gjithëka shpejt po e përfshin,
ja një çast ndalet e pret
aty ku Drinat kanë pikëtakim



Më gënjen mendja e shkretë
se mendoj rashë në qetësi,
valëbashkuar Drini rrëshqet
grykës tutje me furi

E unë mbes flokëshpupurisur
nën këta blinj lakuriqësuar,
me një gjethe shpirtin nisur
valës së Drinit shkumëzuar.



Afsh vargjesh

Më vijnë metaforet rradhë-radhë
gjerdan më ndritin shpirtit, gushës
si dhëndërrin kur sheh për herën e parë
përjetoj drithërimën e nusës

Me afsh rendojnë vargjet
tek zbresin nëpër gjoks
e zemra nis e dridhet...oh mos!

Peshë fluore vargu shëtiti në çdo qelizë
poezia ime mbetur “Monalizë”
çelin fjalët bukur , livadhe, jaseminë
keq jam ngatërruar me vargun, poezinë



Njomje plage

Një pikë shiu ra mbi gjethe
njomi plagë në shpirtin tim,
nis të soset kjo ditë vjeshte
erë e dimrit po mbërrin

Nën qerpik pika e lotit
ndrin vështrimit mjegulluar,
i bën sfidë tekës së motit
ngjyrë e vjeshtës e pruar

Fëshfërijnë gjethet nën bli
si një valle e trishtuar,
pisha nusëron përbri
bleron shpresën e pashuar

Do të vijë pranvera tjetër
të tjera gjethe do të ketë ky bli,
plagë e shpirtit do të ketë mbetur
shenjëzuar, gjithsesi



Fara e dhimbjes

Ku ikën dhe si?

Mos ma mbill terrin në sy

Mos e hidh farën e dhimbjes
vragave të shpirtit tim,
dhimbja shpejt mbin!



Stuhisë së brengës

Gjethë e vetmuar
në degën e pemës,
dridhet frikësuar
prej stuhisë së brengës.

Vërshimi i dhimbjes
oh, stuhi e marrë,
gjethja zverdhëruar
s'mund t'i bëjë ballë

Merre udhën gjethë
rrënjëve të pemës,
bashkë me pranverën
jepi jetë së blertës



Dehje

Pishë e vogël gjelbërore
si princeshë ndër ballkone,
nën mantelin bardhësi
dehem unë e dehesh ti

Na deh ajri akulluar
dhe veshtirimi mjegulluar,
zogjtë sot s'paskan hare
kemi mbetur vetëm ne

Pishë e vogël nën dritare
nis vallëzo me fjolla bore,
zemra ime në dihatje
dhimbjen e ka zënë për dore



Herë pikë loti, herë pikë vese

Në pikë loti, trëndafil,
më ka mbetur dhimbja e shkretë,
e prej dhimbjes mbi pistil
nuk po ulet asnjë bletë

Herë pikë loti, herë pikë vese
rreze dielli, rreze shprese,
drithërimë e ofshamë shpirti
qetësi zemra kurrë s'më diti

Rrjedh damarësh dhimbje e shpresë
loti im, lule mbi vesë,
në krahë zogu mbeti qetësia
turbulencë e netëve të mia



Barka e dhimbjes

Mbi barkën e dhimbjes
nisa unë mendimet,
këtij dimri acar
me shpresën e vrarë

Kristali i zi
thyhet mbi liqen,
shpresa sërisht vjen

Vozit shpresa barkën
tok dhimbjet e mia,
nën akull të zi
mbeti veç lakmia



* * *

Përmbajtja:

- 1- Ditë të brishta
- 2- Flatra shpresës
- 3- Drithërimë
- 4- Frikë
- 5- Sirtaret e zemrës
- 6- Shtrat trishtimi
- 7- Lëndinë shpirti
- 8- Velat e shpirtit
- 9- Dhimbje grykëzënë
- 10- Britmë trishtimi
- 11- Hapsirë
- 12- Çelës i mendjen time
- 13- Lumë i qetë
- 14- Në dridhje qerpiku
- 15- Lohje buzëqeshjesh

16- Terri i brengës



- 17- Rrezja e agimit
- 18- Peshë dëbore mbi petal
- 19- Në prehër të Pashtrikut
- 20- Në kthetra të ëndërrës
- 21- Lule mbi varr zemre
- 22- Përkundje gjumi
- 23- Valle zemërimi
- 24- Hapërim stinësh
- 25- Ora e jetës
- 26- Varg perlat e shpirtit
- 27- Pragut të shpresës
- 28- Në krahë trishtili
- 29- Tutje lakmitar
- 30- Ngjyrë e dhimbjes
- 31- Me gjuhën e heshtjes
- 32- Portat e shpirtit
- 33- Fle me muzën



- 34- Netë të pagjuma
- 35- Pesha e rrahjezembrës
- 36- Hënë prapa reje
- 37- Takim me brymën
- 38- Rrufitje hallesh
- 39- Fund i qetë
- 40- Gjethnajës së shpirtit
- 41- Në kujtime duke shkelur
- 42- Pëshpëritje
- 43- Puthje me valën
- 44- Harrim
- 45- Në lotin e trishtimit
- 46- Mantel gjethesh
- 47- Si zogj të hutuar
- 48- Puhizë nëpër petale
- 49- Trokitje e diellitë
- 50- Frymim fjalësh
- 51- Nuk qasen ëndërrat
- 52- Pa rigë fjalësh
- 53- Ah dhimbjet e mia...



- 54- Litarët e shiut
- 55- Puthje mbi gjethesh
- 56- I ftohtë çdo agim!
- 57- Nën pushtet të mjegullës
- 58- Rradhitmi dhimbjet!
- 59- Më duhesh si dielli
- 60- Kujtimi pushtues
- 61- Xhepfryrë
- 62- Shtrije shikimin!
- 63- Dikujt...
- 64- Zjarrin mbajmë ndezur
- 65- Valë e Drinit shkumëzore
- 66- Afsh vargjesh
- 67- Njomje plage
- 68- Fara e dhimbjes
- 69- Stuhisë së brengës
- 70- Dehje
- 71- Herë pikë loti, herë pikë vese
- 72- Barka e dhimbjes